REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TE ARDHURAVE LEJAVE LICENSAVE DHE BORXHIT

Nr._____Prot. **Bilisht më _____, _____, 2025**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 39 **datë** 24, 06 **, 2025**

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË TAKSËN E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.201"Për vetë qeverisjen vendore",si dhe në mbështetje të ligjit nr.107 datë 31.05.2015 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 46, bazuar VKM Nr.408, datë dhe konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.377/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.408, datë 13.08.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar, Neni 27, Ligjit nr.9632 date 30.10.2006. "Për sistemin e taksave",i ndryshuar, me ligjin Nr 67/2023, date 21.03.2023, Udhëzimi nr.3,datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të banesave nga Enti Kombëtar për vitin 2016", bazuar në VKM Nr 168, datë 27.03.2019 "Për disa ndryshime në VKM 132, datë 07.03.2019".

PROPOZOJ:

1. Për ndërtimet që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit.
   - 3% (tre) për qind e vlerës së investimit, për Qytetin Bilisht
   - 3% (tre) për qind e vlerës së investimit, për Njësite Administrative
2. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit.
   - 1% (një) për qind e vlerës së investimit, për Qytetin Bilisht
   - 1% (një) për qind e vlerës së investimit, për Njësitë Administrative

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/

Shtohet në paketën fiskale

Pas Tarifave të propozuara nga zyra e urbanistikës , shtohet në paketën fiskale

1.Miratimin e heqjes së tarifës të aplikimit për paisjen me leje ndërtimi për shtesa kati dhe leje ndërtimi për objektet një familjare, në zonat rurale, bazuar në VKM Nr.408, datë 13.08.2015 dhe konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.377/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.408, datë 13.08.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar, Neni 11/2, "Procedura e thjeshtuar për paisjen me leje ndërtimi për shtesat në zonat rurale", Neni 11/3 "Procedura e thjeshtuar për pajisjen me leje ndërtimi për objektet një familjare në zonat rurale.

Hartoi
Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit

Bledar Kanina

Konfirmon bazueshmërinë ligjore
Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TË ARDHURAVE, LEJAVE, LIÇENSAVE DHE BORXHIT

Nr. 2061 **Prot.** **Datë** 25, 06, **2025**

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIMIN
"PER DISA NDRYSHIME NË TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.201"Për vetë qeverisjen vendore",si dhe në mbështetje të ligjit nr.107 datë 31.05.2015 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 46, bazuar VKM Nr.408, date dhe konkretisht Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.377/2024 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr.408, datë 13.08.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", te ndryshuar, Neni 27, Ligjit nr.9632 date 30.10.2006. "Për sistemin e taksave",i ndryshuar, me ligjin Nr 67/2023, date 21.03.2023, Udhëzimi nr.3,datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare te banesave nga Enti Kombëtar për vitin 2016", bazuar ne VKM Nr 168, date 27.03.2019 "Per disa ndryshime ne vkm 132, date 07.03.2019"

1. **Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndryshon si mëposhtë:**

Në pikën 2 në paketën fiskale 2025 "*Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike. Të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë nga individi apo me sipërmarrës*" të cilat kanë nivelin e taksës 3%, hiqen ndërtimet në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë të cilat kalojnë në niveli i taksës 1% sipas VKM nr.377/2024.
Gjithashtu shtohet dhe pika për heqjen e taifisë së aplikimit për paisjen me lejë ndërtimi për shtesat kati dhe lejë ndërtimi për objektet familjare, në zonat rurale

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtori i Derjtorisë të të Ardhurave, Lejave, Licensave dhe Borxhit
Bledar Kanina

KRYETARI I BASHKISË
Eduard Duro

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax 0355811123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com